

**KËRKESË**  
**Nr. 4472, datë 28.5.2021**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtim rruge, unazë (ish-kundërajtori)”, Korçë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Korçë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe bazuar në shkresën nr. 52/8 prot., datë 5.3.2021, të Bashkisë Korçë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,500 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Etjen Xhafaj**

**Lista paraprake e shpronësimit të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruge, unazë (ish-kundërajtori)”**

| Nr.                         | Emër/Atësia/Mbiemër    | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. totale                        | Sip. e shpronësimit          | Çmimi                              | Vlera e tokës<br>të vlerësuar<br>(lekë) | Vlera totale/<br>lekë | Shënime                                                                                                                                                                 |
|-----------------------------|------------------------|-----------------|----------------|------------------------------------|------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------------|-----------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                             |                        |                 |                | Tokë<br>“arë”<br>(m <sup>2</sup> ) | Tokë “arë” (m <sup>2</sup> ) | Tokë<br>“arë”<br>(m <sup>2</sup> ) |                                         |                       |                                                                                                                                                                         |
| 1                           | Pandeli Arqile Tarusha | 8563            | 2/210          | 1000                               | 165                          | 100                                | 16,500                                  | 16,500                | Me urdhrin nr. 36, datë 13.3.2018, të regjistruarit, në zbatim të nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, vendoset kufizim deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor |
| Vlera totale e shpronësimit |                        |                 |                |                                    |                              |                                    |                                         | 16,500                |                                                                                                                                                                         |

Shënime.

Vlerësimi i tokës arë është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” dhe në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.